

# Buletini i Lajmeve të Sigurisë Kibernetike

Maj 2022



## KRIJIMI I NJË MJEDISI TË SIGURT DIGJITAL PËR FËMIJËT DHE TË RINJËTË



ITU Global Project on Child Online Protection  
**Creating a safe and  
empowering digital  
environment for children**

A global project to  
implement the 2020 ITU  
guidelines on child online  
protection (COP) through  
digital skills development  
and policy support



**Stop Human  
Trafficking**

Në kuadër të implementimit të Planit të Veprimit të "Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025", AKCESK ka vijuar organizimin e fushatave të ndërgjegjësimit online dhe fizikisht, me pjesëmarrës nga institucione publike e private, prindër, mësues dhe fëmijë e të rinj, në qarqe të ndryshme të Shqipërisë.

AKCESK është institucioni i parë në botë që u angazhua për pilotimin e projektit global të International Telecommunication Union "Creating a safe and empowering digital environment for children". Gjithashtu, në linjë me objektivat e strategjisë, AKCESK po implementon projektin "Transformimi i përgjigjes kombëtare ndaj trafikimit të qenieve njerëzore në dhe nga Shqipëria", zbatuar nga UNICEF në Shqipëri me mbështetjen e Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Trajnimet e realizuara përgjatë muajit Maj 2022 kanë target grupin e mëposhtëm:

- nxënësit e shkollave 9-vjeçare të qyteteve Patos, Roskovec, Belsh, Divjakë, Librazhd, Mallakastër, Dimal, Përrenjas, Selenicë dhe Kuçovë.
- prindërit dhe mësuesit e Shkollave të Mesme dhe 9 vjeçare në Babrru, Kamëz, Paskuqan, Vorë, Kavaje, Kukës, Shkodër, Has, Vau Dejës, Fushë Arrëz, Pukë, Tropojë, Dibër, Klos, Burrel, Bulqizë
- Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve në qarkun e Tiranës, Dibrës, Shkodrës dhe Kukësit
- Ofruesit e Shërbimit të Internetit, të cilët operojnë në Republikën e Shqipërisë

Qëllimi i trajnimeve është rritja e ndërgjegjësimit të nxënësve, prindërve dhe mësuesve, punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve dhe Ofruesve të Shërbimit të Internetit mbi rreziqet potenciale kibernetike që hasin fëmijët gjatë lundrimit në internet, si dhe edukimi mbi mënyrat e raportimit të përmbajtjeve të paligjshme e të dëmshme. Rezultatet e trajnimeve janë:

- 4500 përdorues unik online në fushatën e ndërgjegjësimit online
- 320 prindër dhe mësues të trajnuar
- + 250 nxënës të trajnuar
- + 50 përfaqësues të industrisë të trajnuar



Foto nga Trajnimet me Prindërit dhe mësuesit




Foto nga Trajnimet me nxënësit




Foto nga Trajnimet me Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve




Foto nga Trajnimet me Ofruesit e Shërbimit të Internetit

**KONTAKT**

Rr. "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I, Tiranë Albania 04-22-21039

Email: [info@cesk.gov.al](mailto:info@cesk.gov.al)

Web: [www.cesk.gov.al](http://www.cesk.gov.al)